

Bibël për fëmijët
paraqet



Princi Bëhet
Bari



Shkruar nga: Edward Hughes

Ilustruar nga: M. Maillot; Lazarus

Adaptuar nga: E. Frischbutter; Sarah S;
Alastair P.

Përkthyer nga: Arianit Iljazi

Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

©2021 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.



Një ditë, Moisiu,
pa një Egjiptas
që rrihte një
skllav Hebre.



Megjithëse Moisiu ishte rritur dhe edukuar si një princ në pallatin e Faraonit, ai gjithashtu ishte një Hebre. Ai duhej ta ndihmonte skllavin.



Pasi pa mirë e mirë rreth e qark dhe u sigurua që asnjëri nuk po shihte, Moisiu e sulmoi rojen mizor të skllëvërve. Në dyluftimin që pasoi, Moisiu e vrau Egjptasin. Me shpejtësi ai e varrosi trupin.



Ditën tjetër, Moisiu pa dy Hebrenj që ziheshin. Ai u përpoq ti ndalojë ata. Njëri prej tyre tha, "Do të më vrasësh siç vrave Egjiptasin"? Moisiu u frikësua. Gjthkush e dinte ç'kish ndodhur dje. Edhe Faraoni e dinte. Moisiu duhej t'ia mbathte. Ai shkoi në një vend që quhej Madian.



Ndërsa Moisiu po pushonte pranë një pusi, të shtata vajzat e Priftit të Madianit mbushën ulluqet me ujë për bagëtinë e atit të tyre.



Barinjtë e tjerë u përpogën ti shtyjnë ato tutje.
Moisiu i mbrojti dhe i ndihmoi gratë.



"Ju jeni në shtëpi
herët", Reueli, tha
babai i vajzave. Kur
vajzat i shpjeguan
sesi, ai tha, "Silleni
atë njeri këtu".
Moisiu jetoj
me Reuelin, i
cili quhej edhe

Jethro. Më vonë
Moisiu u martua
me vajzën më të
rritur të Reuelit.



Në Egjipt, Faraoni vdiq.
Njerëzit e Perëndisë,
Hebrenjtë, ishin ende
skllëvër. Oh sa lëngonin
ata në vuajtje!

Sa shumë u
lutën ata për ndihmë
nga Perëndia! Perëndia i
dëgjoji lutjet e tyre.



Moisiu nuk e dinte, por Perëndia
kishte në plan ta përdorte atë për të
ndihmuar Hebrenjtë e skllavëruar.

Dyzet vjet kaluan, qysh kurse
Moisiu kishte lënë Egjiptin.

Ai ishte bariu i bagëtisë së
Reuelit. Por atë duhet ta
kishte marrë malli për


njerëzit e
tij në Egjipt.



Një ditë, Moisiu, vuri re aty pranë një shkurre në flakë. Por zjarri nuk po e digjte shkurren. Moisiu vendosi të zbulojë përse.




Ndërsa Moisiu u afrua, Perëndia e thirri atë prej shkurre. "Moisi"! "Këtu jam", tha Moisiu. "Mos u afro tepër", tha Perëndia. "Hiqi sandalet, sepse vendi ku qëndron është vend i shenjtë".



“Unë do të dërgoj tek Faraoni për të nxjerrë
njerëzit e mi jashtë nga Egjipti”,
tha Perëndia. Por Moisiu kishte frikë
të shkonte.



Atëherë, Perëndia i tregoi Moisiut fuqinë e Tij të madhërishme. Ai e ktheu shkopin e Moisiut në një gjarpër.



Kur Moisiu e kapi gjarprin nga bishti, ai u bë shkop sërisht. Perëndia dha një shenjë tjetër.




"Vëre dorën në krahërorin tënd", urdhëroi Ai.
Moisiu bëri ashtu. Dora e tij u kthye e
bardhë me lepër.



Kur ai e bëri përsëri, dora e tij u shërua.



Moisiu përsëri kundërshtoi. "Unë nuk flas mirë", i tha ai Perëndisë. Perëndia u zemërua. "Unë do të përdor Aronin, vëllain tënd për të folur fjalët që ti do t'i tregosh", tha Ai.



Moisiu u kthye tek Jethro,
paktoi ç'ka i përkiste dhe
u largua për në Egjipt.



Perëndia e drejtoi vëllain
e Moisiut, Aronin, që ta
takonte Moisiun në male.
Moisiu i tregoi gjithçka
Aronit, përsa i përket
planit të Perëndisë për
çlirimin e popullit
Hebre prej
Egjiptasve.



Së bashku ata ia çuan
lajmin udhëheqësve
Hebrenj. Kur Moisiu
u tregoi shenjat
udhëheqësve
Hebrenj, ata
e kuptuan se
Perëndia do ti
ndihmonte ata.
Së bashku ata
ranë përmbys
në adhurim.




Trimërisht, Moisiu dhe Aroni shkuan tek Faraoni. "Perëndia thotë, 'Lëri njerëzit e mi të shkojnë'", i thanë ata Faraonit.



“Unë nuk do ta lë Izraelin të shkojë”,
u përgjigj Faraoni. Ai nuk donte ti
bindej Perëndisë.



Perëndisë, do ti duhej të përdorte fuqinë e Tij të madhërishme për të ndryshuar mendjen e Faraonit.



Princi Bëhet Bari

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla

e marrë nga

Eksodi 2-5

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130



Fund



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

